

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Në fakt, të na japësh ti, zoti Balla, leksione për shkresat, për shtetin, për administratën e ku di unë, është t'ia fusim nga ky parlament të gjithë me vrap.

Zonja Kryetare,

Në datën 24 maj Konferenca e Kryetarëve rrëzoi kërkesën e parë për ngritjen e komisionit hetimor të paraqitur nga opozita me pretendimin e ngritur prej jush, që kolegu Agron Duka ishte tërhequr nga kërkesa për komisionin hetimor. Ky njoftim iu bë nismëtarëve në Konferencën e Kryetarëve. Me pretendimin tuaj se nga 35 firma tashmë kishin mbetur të vlefshme 34 firma, ju e rrëzuat kërkesën për komisionin hetimor, në kundërshtim flagrant me ligjin. Sipas ligjit, zonja Kryetare, dhe për këtë do të duhej të kishit treguar ju kujdes, duke qenë se jeni betuar për të respektuar të drejtat kushtetuese të opozitës, sipas pikës 2 të nenit 5 të ligjit “Për komisionet hetimore”, mjaftojnë 5 firma të deputetëve që kërkesa për komisionin hetimor të shqyrtohet nga seanca plenare.

Ekzistenca apo jo e 35 firmave e bën të detyrueshëm ose jo ngritjen e komisionit, por nuk nevojiten 35 firma që kërkesa të vijë në seancën plenare dhe të shqyrtohet nga kjo e fundit. Megjithatë, për të mos u futur në një diskutim ligjor, 34 nismëtarët e tjerë të kërkesës për komision hetimor, se zotëria na u ngrit këtu dhe tha “Vullneti i një deputeti rrëzua vullnetin e 34 deputetëve të tjerë”, kemi paraqitur në datën 27, dhe nuk ka asnjë gjë për t'u fshehur, një kërkesë ku sqarojmë: pasi jemi njohur me tërheqjen e firmës nga deputeti Agron Duka të njoftuar nga Kryetarja e Kuvendit në Konferencën e Kryetarëve, kemi bërë korrigjimin dhe pasqyrimin e këtij fakti në kërkesën për komisionin hetimor. Kemi ridepozituar me firma origjinale një kërkesë të 36 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Kërkesa është depozituar konform Rregullores së Kuvendit, konform ligjit “Për komisionet hetimore” dhe, sigurisht, konform përgjegjësisë, por edhe të drejtës që ka opozita për të ushtruar kontroll parlamentar. I gjithë sqarimi që ju, zonja Kryetare, keni bërë në Konferencën e Kryetarëve (meqë ra fjala nuk i dimë ende arsyet pse, sipas administratës së Kuvendit, procesverbali nuk është zbardhur ende), por edhe sqarimi që dha zoti Balla këtu, është thjesht dhe vetëm një justifikim, sepse qytetarët shqiptarë janë dëshmitarë se një javë përpara se ne të depozitonim kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor nga këtu ku po flas unë tani, Kryeministri tha: “Harrojeni se do të ngremë komision hetimor për të hetuar dhe për të verifikuar procedurat për investimet strategjike”.

Shqiptarët duhet t’i dinë arsyet pse këta e bllokojnë ngritjen e komisionit hetimor për investimet strategjike. Së pari, sepse një deputet i këtij Kuvendi, që është edhe një nga ministrat më të rëndësishëm të kabinetit “Rama”, rrezikon, e para, mandatin, e dyta, të shkojë në burg, sepse në kushtet flagrante të konfliktit të interesit bashkëshorti i saj ka përfituar statusin e investitorit strategjik. Nga ana tjetër, individë anonimë me kompani në offshore kanë përfituar të gjitha projektet për investimet strategjike; pasuritë publike janë kthyer në plaçkë, ku ministrat ndajnë pronat publike me njëri-tjetrin dhe Kryeministri zgjohet në mëngjes dhe vendos se cilit prej miqve të oborrit të tij do t’i japë një copë tokë në bregdet apo një pasuri të caktuar shtetërore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo është arsyeja. Duhet të jenë të ndershëm me shqiptarët, por ju vini këtu dhe nuk dini çfarë flisni. Keni një kërkesë me 36 firma dhe thoni: “Është falsifikuar”.

Zonja Kryetare, merreni listën e 36 firmëtarëve. Ja, ku i ke kolegët në seancë dhe pyeti: “A e kanë ata vullnetin për të ngritur komision hetimor? A e kanë ata vullnetin për të hetuar dhe për të verifikuar të gjitha procedurat e dhënies së statusit të investitorit strategjik në këta 5 vjet që ka funksionuar ligji?” dhe, nëse ndonjëri prej tyre thotë se nuk kam vullnet, do të thotë se ne i kemi falsifikuar firmat. Por ju jeni mësuar që falsifikoni nga mëngjesi deri në darkë, se bëni 17 procedura për të vjedhur me inceneratorët dhe mendoni që secili prej nesh në këtë sallë është njëlloj si ju. Nuk jemi njëlloj si ju. Ne jemi këtu për t’i shërbyer interesit publik, ju jeni për t’i

shërbyer Olta Xhaçkës dhe 3-4 personave të tjerë, që kanë përfituar statusin e investitorit strategjik.

Ta harroni se mund të bllokoni një komision hetimor të kërkuar nga opozita, konform Kushtetutës dhe ligjit! Sigurisht që me forcën e kartonit mund ta votoni kundër, se nuk do të vijmë të votojmë për ju, por, së pari, dilni zbuluar që me atë ligj është abuzuar, që miqtë tuaj, miqtë dhe familjarë të ministrave përfitojnë paga në kundërshtim me ligjin, në kushtet e konfliktit të interesit dhe në mënyrë korruptive përfitojnë pasuri publike. Doni apo nuk doni ju, me votë pro apo kundër, opozita do ta bëjë transparencën e plotë për sa u përket investimeve strategjike. Faleminderit!